

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mbi 10 mijë vendime divorcesh/ Ambient i posaçëm në Pogradec për takimet prind-fëmijë
ADRESA	https://www.cna.al/sociale/mbi-10-mije-vendime-divorcesh-ambient-i-posacem-ne-pogradec-per-takimet--i474893
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:05:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 12:31:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	88fb7c938e689986f7424e4444866c63f0811a7cb8b6265f1dd16335074806ed
TEKSTI	254d1311e57131eb0bb0b6dcb0bd5a6822ff339ad740a8e891f013fcb2eb7485
PAMJA	76ed53cfb0d5100f704aea7c891373c1bf6749e981963e2169060b9a2d944ad0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2e67f3e674df3f419c6163e8c7f71ea24f3736a2dd06bb092a4a59dc8c603d6b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2e67f3e674df3f419c6163e8c7f71ea24f3736a2dd06bb092a4a59dc8c603d6b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)




English
English

Mbi 10 mijë vendime divorcesh/ Ambient i posaçëm në Pogradec për takimet prind-fëmijë



22 Shtator 2026, 14:31, Sociale CNA



Një hapësirë e posaçme dhe miqësore për fëmijët është inauguruar pranë Zyrës Përmbartimore në Pogradec. Ambienti do të shërbejë për takimet e fëmijëve me prindërit e divorcuar, në zbatim të vendimeve gjyqësore, duke synuar shmangien e stresit dhe presionit që mund të krijojnë procedurat përmbartimore. Në ceremoninë e inaugurimit morën pjesë zëvendësministria e Drejtësisë, drejtori i Përgjithshëm i Përmbartimit dhe përfaqësues të institucioneve të drejtësisë.

Hapësira e re është konceptuar si një ambient i sigurt dhe i përshtatshëm për fëmijët, ku takimet me prindërit të zhvillohen në kushte më njerëzore dhe larg atmosferës formale të një institucioni përmbartimor.





Zëvendësministria e Drejtësisë, Elona Hoxha, e cilësoi këtë nismë si një hap drejt një sistemi drejtësie më të ndjeshëm ndaj nevojave të fëmijëve, duke theksuar se interesi më i lartë i tyre duhet të jetë në qendër të çdo procedure.

“Ajo që përurojmë sot nuk është thjesht një ambient i ri. Ai është një hap konkret drejt një drejtësie më njerëzore, më të aksesueshme dhe më të ndjeshme ndaj nevojave të fëmijëve. Një institucion i drejtësisë nuk duhet të jetë për fëmijën një hapësirë që krijon frikë apo pasiguri. Përkundrazi, duhet të jetë një vend ku ai ndihet i mirëpritur, i dëgjuar dhe i respektuar”,-tha Hoxha.

Sipas drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit, Ergys Qirici, në fokus të punës së strukturave përmbarimore janë mijëra vendime gjyqësore që lidhen me fëmijët, përfshirë jo vetëm takimet me prindërit, por edhe detyrimet për pensionet ushqimore. Qirici bëri të ditur gjithashtu një risi në mënyrën e njoftimit të debitorëve që ndodhen jashtë territorit të Shqipërisë ose kur adresa e tyre nuk mund të gjendet.


Qirici tha se janë mbi 10 mijë vendime gjyqësore që lidhen me çështje të tilla, ndërsa theksoi se prioritet mbetet mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës.

“Janë gjithsej mbi 10 mijë vendime gjyqësore. Pjesa më e madhe nuk lidhet vetëm me takimin e fëmijës, por edhe me pensionet ushqimore dhe çështje të tjera. Fokusi i Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit dhe i Ministrisë së Drejtësisë është që interesi më i lartë i fëmijës të jetë prioritar”,-tha Qirici.

Ndërsa për familjet që përballen me pamundësi financiare për të ndjekur procedurat, institucionet ofrojnë edhe mekanizma të ndihmës juridike, përfshirë asistencën me avokat dhe mundësinë e përjashtimit nga tarifat përmbarimore, në përputhje me parashikimet ligjore.



Hapësira të tilla synojnë që zbatimi i vendimeve gjyqësore për takimet prind-fëmijë të kryhet në një mjedis më të sigurt dhe më të përshtatshëm për të miturit, duke vendosur në qendër të procesit nevojat dhe mirëqenien e tyre./CNA





Të sugjeruara

Në Shqipëri ka 28 mijë gra më shumë sesa burra, ndonëse në vend lindin më shumë djem

Vranësira dhe reshje shiu/ Moti për ditën e sotme

Punësimi në shtet rritet sërish për tremujorin e dytë, mbi 186 mijë kontribuues

Vranësira dhe kthjellime/ Moti për ditën e sotme

Kaos në Korçë/ Maratona bllokon rrugët, shoferët kalojnë mes fshatrave

Kostoja e lindjes së një fëmije në Europë/ Ja cilat vende janë më të shtrenjta, si renditet Shqipëria

Kuqta stresaforika të sapëndurshme/ Dërraskimi i motit për ditën e sotme

[ANUNIS QUMOSISTARS E PARASHIKUESHME/ PARASHIKIMI I MOTIT PER DITEN E SOTME](#)

[Fëmijët po hyjnë gjithnjë e më herët në rrjetet sociale/ Çfarë po i shqetëson ekspertët?](#)

[Vranësira dhe kthjellime/ Moti për ditën e sotme](#)

[Breshëri dëmton prodhimet bujqësore në Biran/ Fermerët në hall: Humbje me miliona lekë, na iku mundi](#)

[Gati gjysma e shqiptarëve kanë vështirësi të mbyllin muajin, e dyta në Europë](#)

[Kthjellime dhe vranësira kalimtare/ Parashikimi i motit, 18 shtator](#)

[Të rinjtë u lënë vendin të moshuarve/ Punësimi i pensionistëve dyfishohet në tri vjet](#)

[Kthjellime dhe vranësira kalimtare/ Moti për ditën e sotme](#)

[Shtrenjtimi i tarifave “zbraz” bankat e shkollave private, ku po shkojnë nxënësit](#)

[Kthjellime dhe vranësira lokale/ Moti për ditën e sotme, 16 shtator 2026](#)

[Alternime kthjellimesh dhe vranësira/ Parashikimi i motit, 15 shtator 2026](#)

[Viti i ri shkollor/ Bie numri i nxënësve në qarkun e Korçës](#)

[Sa \(shtrenjtë\) kushton dita e parë e shkollës?](#)


[Nis sot viti i ri shkollor 2026-2027](#)

[editorial](#)

16:30 Editorial

Agasi, Veliaj, Proda, Hyseni: Harta e një shteti që po shpërbëhet

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.